



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr 566/2 Prot

Tiranë, më 26/02/2020

U R D H Ë R

Nr 53/2, Datë 26/02/2020

PËR

NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË KARANTINËS NË MJEDISE TË PËRCAKTUARA.

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 7, pikat 2 dhe 3 dhe 21, pika 4 të Ligjit Nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive".

URDHËROJ:

I. Ngritjen e shërbimit të karantinës sipas kriterëve të përcaktuar si poshtë vijon:

- a) Të ketë mjedise individuale ose mjedise në grup për persona të caktuar, për të cilët ka të dhëna epidemiologjike të mjaftueshme për një sëmundje infektive me impakt në shëndetin publik.
- b) Të sigurojë shërbim shëndetësor 24 orë dhe kontroll periodik shëndetësor të personave sipas grupmoshave që janë në karantinë.
- c) Të sigurojë në bashkëpunim me Shërbimin e Epidemiologjisë dhe Shëndetit Mjedisor (NJVKSH përkatëse) dhe ISHP, testimin për sëmundje infektive të rrezikshme në momentin e hyrjes në shërbimin e karantinës dhe më tej duke ndjekur protokollin përkatës brenda kushteve të karantinës.
- d) Për personat në mjediset e karantinës duke përfshirë dhe personelin që punon në karantinë MSHMS të bashkërendojë punën me institucionet e tjera dhe të mbulojë shpenzimet e shërbimit të karantinës për të gjitha kushtet bazike të hotelerisë, ushqimit, furnizimit me ujë të pijshëm, si edhe masat bazë higjieno sanitare.
- e) Zgjatjen e shërbimit në karantinë deri sa të plotësohet periudha sipas inkubacionit të sëmundjes infektive, duke u nisur nga koha që personi mund të ketë patur kontakt me një person të infektuar apo të ketë udhëtuar në një vend të infektuar.

- f) Të vendosen në mjediset e shërbimit të karantinës shenjat përkatëse që ky është shërbim i karantinës.
- g) Personat në karantinë nuk lejohet të kenë kontakte me asnjë person përveç personelit që shërben në karantinë.
- h) Nëse një person jashtë karantinës ka kontakt me një person në karantinë, detyrohet të kryejë karantinën sipas kohës së përcaktuar për kontaktet.
- i) Mjediset e shërbimit të karantinës të ruhen nga Policia e Shtetit.
- j) Personeli që shërben në karantinë të përbehet nga grupe me përberje mjekë, infermierë, punonjës social/psikolog dhe sanitarë duke kryer zëvendësimin sipas një grafiku të përcaktuar.
- k) Personeli që shërben në shërbimin e karantinës të zbatojë rregullat e kontrollit të infeksionit dhe të shërbejë duke përdorur të gjitha mjetet e mbrojtjes personale, sipas protokolleve përkatëse.
- l) Mjediset e karantinës të jenë të pajisur me pompa dhe dezinfektantë dhe të zbatohen rregullat e dezinfektimit.
- m) Në mjediset e karantinës të zbatohen rregullat e menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme sipas protokolleve, më pas asgjësohen sipas të gjitha rregullave të asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme.
- n) Çdo mjedis brenda karantinës të pastrohet vetëm kur ambjenti lirohet nga personi i shëndetshëm dhe çdo mjedis brenda karantinës dezinfektohet kur personi rezulton i sëmurë.
- o) Për çdo person të shëndetshëm në fund të procesit të karantinës të jepet shkresë përcjellëse e vulosur nga shërbimi shëndetësor i karantinës, ku vërtetohet qëndrimi në karantinë dhe gjendja shëndetësore e tij.
- p) Kur personi në karantinë konstatohet apo dyshohet të ketë shenja të sëmundjes përkatëse të kryhet konsulta me mjekun infeksionist dhe të sigurohet transporti duke ndjekur të gjitha rregullat përkatëse të kontrollit të infeksionit drejt mjediseve të përcaktuara të izolimit në Shërbimin e Sëmundjeve Infektive në QSUT, apo mjedis tjetër të përcaktuar për izolim nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- q) Kur personi në karantinë mund të ketë sëmundje të tjera bazë apo akute, të kryhen konsulta apo të ofrohet shërbimi shëndetësor përkatës përfshi këtu edhe testime të tjera duke respektuar të gjitha masat e kontrollit të infeksionit.
- r) Shërbimi shëndetësor dhe ai psikosocial që shërben në karantinë të trajnohen nga ekspertët e ISHP dhe Shërbimit Kombëtar të Sëmundjeve Infektive.
- s) Funksimi i shërbimit të karantinës të monitorohet nga MSHMS dhe ISHP.
- t) Çdo person që është në karantinë i cili tenton apo thyen rregullat e karantinës dënohet sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.
- u) Çdo person nga jashtë që tenton apo thyen rregullat e karantinës dënohet sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

2. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Instituti i Shëndetit Publik, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Shërbimi infektiv pranë QSUT dhe Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi", për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


MINISTRI
Ogerta Manastirliu

